



**DEPARTAMENTI I EPIDEMIOLOGJISË DHE KONTROLLIT TË  
SËMUNDJEVE INFEKTIVE**

**BULETINI MUJOR I  
SËMUNDSHMËRISË  
INFEKTIVE  
(Pasqyra 14 Sh)**

TETOR, 2024

Buletini Mujor i Sëmundshmërisë Infektive publikohet çdo muaj nga Sektori i Survejancës dhe Shërbimi i Inteligjencës Epidemike, Instituti i Shëndetit Publik (ISHP) dhe bazohet në të dhënat e raportuara përmes Pasqyrës Mujore 14 Sh dhe Sistemit të Informacionit të Sëmundjeve Infektive (SISI). Të dhënat e agreguara të Pasqyrës 14 Sh dhe të dhënat individuale të raportuara në SISI për muajin tetor 2024 janë të dhënat e raportuara nga Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor (NJVKSH) të cilat krahasohen nga Departamenti i Epidemiologjisë dhe Kontrollit të Sëmundjeve Infektive (DEKSI), dhe plotësohen edhe me të dhënat e laboratorëve të referencës në ISHP. Ky raport paraqet kryesisht rastet e konfirmuara dhe në disa raste edhe rastet e dyshuara dhe të konfirmuara.

### **1. Sëmundjet diarreike**

Sëmundjet diarreike gjatë muajit tetor 2024 zënë 34.4 % të totalit të sëmundjeve infektive të raportuara me anë të Pasqyrës 14 Sh, dhe paraqesin një incidencë 285.4/100.000 banorë. Gastro-enteritet e paspecifikuara janë të shpërndara në të gjitha bashkitë e vendit dhe zënë peshën kryesore në grupin e sëmundjeve diarreike. Ndërkohë që, në nivel kombëtar helmimet ushqimore paraqesin një incidencë 4.1/100.000 banorë. NJVKSH Berat, Kukës dhe Bulqizë mbajnë peshën kryesore në raportimin e helmimeve ushqimore. Duhet theksuar që, numri i lartë i rasteve të raportuara me helmime ushqimore dhe gastro-enterite është i lidhur me pamundësinë në nivelin e disa bashkive për diagnozën e saktë klinike dhe konfirmimin e saj me diagnozën laboratorike mikrobiologjike. NJVKSH Shkodër mban peshën kryesore të incidencës së Salmonelozës dhe Shigelozës për muajin tetor 2024 në nivel kombëtar.

Gjatë muajit tetor 2024 vihet re një rritje e rasteve me toksiko-infeksion alimentar dhe gastro-enterit të paspecifikuar në Dibër kryesisht me: diarre, dhimbje barku, nauze. Shtimi i rasteve ka vijuar nga data 7.10.2024 deri më datë 15.10.2024. Në total janë paraqitur 260 persona për ndihmë mjekësore. Të gjitha rastet i përkasin zonave rurale. Nga hetimi epidemiologjik rastet rezultojnë pa lidhje epidemiologjike me njëri-tjetrin, dhe nuk kanë marrë pjesë në ndonjë grumbullim (dasëm, fatkeqësi etj). NJVKSH Dibër në bashkëpunim me ISHP ka bërë hetimin në terren, janë marrë mostra klinike (tampona rektal) për ekzaminim bakteriologjik dhe virologjik, si dhe mostra uji për të vlerësuar parametrat fiziko-kimik dhe mikrobiologjik. Gjatë investigimit personat e paraqitur janë pyetur lidhur me produktet ushqimore që kanë konsumuar dhe furnizimin me ujë. Të gjithë fshatrat e përfshira furnizohen me ujë nga i njëjti burim. Karakteristika e kurbës epidemike të shpërthimit është e ngjashme me shpërthim me origjinë hidrike me ndotje me burim pikësor, uji paraqet ndotje bakteriale. Janë marrë masat përkatëse për furnizimin e popullatës me ujë të sigurt, trajtimi dhe monitorimi i rasteve.

***Tabela 1: Frekuencat dhe incidencat e sëmundjeve diarreike për muajin tetor 2024 (Incidenca raste/100.000 banorë)***


	Raste tetor 2024	Incidenca tetor 2024 (raste/100.000 banorë)
Tifo abdominale + Paratifo	0	0.00
Salmoneloza	12	0.4
Shigelozë (Disenteri bacilare)	5	0.1
Dizenteri amebike	0	0.0
Toksiko-infeksione alimentare	118	4.1
Gastro-enterite (etiologji e panjohur)	8036	280.7
Sëmundje diarreike në total	8171	285.4

## 2. Sëmundjet që parandalohen nga vaksina

### 2.1 Variçela

Në raportimin mujor të sëmundshmërisë infektive gjatë muajit tetor 2024 janë raportuar në total 130 raste variçelë (incidenca 4.5/ 100.000 banorë ) nga të cilat, 54 raste janë të dyshuara dhe 76 të konfirmuara klinikisht, bazuar kjo në përkufizimin e rastit për sëmundjen variçelë. Numri më i madh i rasteve është raportuar nga NJVKSH Tiranë me 75 raste. Numri më i lartë i rasteve i përket grup-moshës 1-4 vjeç me 67 raste, grafiku 1.


**Grafiku 1. Shpërndarja e rasteve sipas grup-moshës, tetor 2024**



### 2.2 Fruthi

Gjatë muajit tetor nuk është raportuar asnjë rast me fruth.

**Grafiku 2. Shpërndarja e rasteve të konfirmuara me fruth dhe incidenca sipas muajve 2024**




### 3. Hepatitet virale

#### Hepatit viral B (HBV)

Në muajin tetor janë raportuar 8 raste të konfirmuara me HBV. Incidenca e HBV-së në muajin korrik është 0.3 raste/100 000 banorë në vend.

**Grafiku 3. Numri i rasteve të reja me HBV dhe incidenca (raste/100 000 banorë) sipas muajve**




Rastet në muajin tetor i përkasin grup-moshës adulte nga 30-75 vjeç, 7 raste (88%) të gjinisë mashkull dhe 1 femër (12%), janë banorë nga bashkia Gjirokastër (1), Berat (1) Lushnjë (3) dhe Bulqizë (3), dhe kanë shfaqur shenja klinike të HBV-së.

#### Hepatiti viral C (HCV)

Në muajin tetor është raportuar një rast i konfirmuar me HCV. Rasti i përket bashkisë Fier i moshës 43 vjeç, gjinia mashkull, dhe ka shfaqur shenja klinike të HCV-së.

**Grafiku 4. Numri i rasteve të reja me HCV dhe incidenca (raste/100 000 banorë) sipas muajve**



#### 4. Tuberkulozi pulmonar dhe ekstrapulmonar

Gjatë muajit tetor 2024 janë raportuar gjithsej 23 raste me tuberkuloz (TB). Prej të cilave 18 raste janë pulmonare dhe 5 raste ekstrapulmonare.

Rastet e raportuara me TB pulmonar janë të konfirmuara dhe me sputum pozitiv.

Rastet pulmonare përkatësisht janë: 5 në Tiranë, 2 në Dibër, 1 në Mirditë, 2 në Lezhë, 1 në Kukës, 3 në Shkodër, 1 në Korçë, 1 në Berat, 1 në Mat dhe 1 në Elbasan.

Rastet ekstrapulmonare përkatësisht janë 5 raste: 2 në Tiranë, 1 në Shkodër, 1 në Lushnjë dhe 1 në Lezhë. Raste recidive për muajin tetor janë 3: 1 në Shkodër, 1 në Lezhë dhe 1 në Mirditë.

Konfirmimet e tyre janë kryer në Laboratorin e Referencës të rekomanduara nga dispanseria e rrethit përkatës. Për të gjitha rastet janë lajmëruar dispanseritë përkatëse për të komunikuar me familjarët e tyre, si dhe për të kryer kontrollin në vatër bazuar në të gjitha ekzaminimet për depistimin e tyre. Pothuajse të gjithë pacientët kanë filluar mjekimin sipas skemës përkatëse. Siç vihet re dhe nga shpërndarja e rasteve, ato me TB janë të fokusuara kryesisht në Tiranë me numër më të madh.

#### 5. Sëmundjet zoonotike

*Tabela 2: Shpërndarja e zoonozave në muajin tetor 2024, numri total i rasteve dhe incidenca (Antraks, Brucelozë, Leptospirozë, Rikeciozë)*

	Tetor (raste 2024)	Incidenca (raste/100,000) 2024
Antraks (Plasje)	0	0
Brucelozë	3	0.10
Leptospirozë	1	0.03


Për muajin tetor janë raportuar 3 raste Brucelozë përkatësisht: 1 në Shkodër, 1 në Kolonjë dhe 1 në Sarandë. Gjithashtu është raportuar edhe 1 rast i konfirmuar me Leptospirozë nga Tirana

## 6. Sëmundje infektive me transmetim përmes ajrit

### 6.1 COVID-19

Gjatë muajit tetor 2024 janë raportuar në Sistemin e Informacionit të Sëmundjeve Infektive 24 raste të konfirmuara me COVID-19, dhe incidenca e kësaj sëmundjeje për muajin tetor është 0.83 raste /100000 banorë.

*Grafiku 5. Shpërndarja e incidencës sipas grup-moshave*



Grup-mosha më e prekur për këtë muaj është grup-mosha 75+ vjeç me incidencë 5.42 raste për 100000 banorë, e ndjekur nga grup-mosha 65-74 vjeç me incidencë 1.63 raste për 100000 banorë.

*Grafiku 6. Shpërndarja e incidencës sipas bashkive*



Bashkitë me incidencë më të lartë janë Gjirokastra, Himara, Belshi, etj.

Gjatë muajit tetor 2024 janë raportuar 5 raste të shtruara në spital dhe asnjë raste vdekjeje. Konfirmimi i rasteve është bërë në 29% (7 raste) në ISHP dhe 71% (17 raste) janë konfirmuar në laboratorët e NJVKSH-ve.

### 7.1 Grip


Gjatë muajit tetor janë testuar 360 mostra për grip, dhe vetëm 1(0.28%) ka rezultuar pozitive me Grip Tipi A.

## 7. Sëmundje të tjera

### 8.1 Infeksioni nga virusi i Nilit Perëndimor (WNV)

Gjatë muajit tetor në vendin tonë janë konfirmuar pranë laboratorit të virologjisë në ISHP, 2 raste me WNV.

**Grafiku 7. Shpërndarja e rasteve të konfirmuara sipas fillimit të shenjave, korrik-tetor 2024**





*Tabela 3. Shpërndarja e rasteve të konfirmuar sipas bashkive*

Bashki	Raste të konfirmuara	% e pozitivitetit
Durrës	1	50
Kuçovë	1	50
Total	2	100.0

Rastet i përkasin moshës 63 vjeç, të gjinisë mashkull, janë të shtruar në spital ku kanë paraqitur shenja të encefalitit apo meningo-encefalitit.

Nga ana e ISHP-së në bashkëpunim me NJVKSH dhe bashkitë përkatëse janë marrë masat e nevojshme për ndërprerjen e transmetimit të sëmundjes.

## **8.2 Leshmanioza Viscerale**

Për muajin tetor 2024 është raportuar 1 rast i konfirmuar në laborator privat me Leshmaniozë Viscerale nga Tirana.

INSTITUTI I SHËNDETIT PUBLIK, DEKSI